

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

“MAM DISTRIBUTION” Sh.p.k

I. THEMELIMI

**NENI 1
Ortaket themelues**

Shoqeria krijohet nga unë ortaku themelues:

- Z. Alvina Zyberaj, shtetas shqiptar, lindur më 26.04.1990 në Vlore, Shqiperi, identifikuar me dokument identifikimi pasaporte nr. BA9113627 dhe numer personal J05426105A, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

II. EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE - OBJEKTI

**NENI 2
Emertimi**

Shoqeria emertohet **“MAM DISTRIBUTION” Sh.p.k**

**NENI 3
Forma juridike**

Forma juridike do të jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per shoqerite Tregtare”.

**NENI 4
Selia**

4.1 Shoqeria **“MAM DISTRIBUTION” Sh.p.k** e ka seline e saj ne adresen: *““Rruga e Kavajes, Pallati 12, kati 5, apartamenti nr 29, Njesia Administrative nr 7, Tirane, Shqiperi”*.

4.2 Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund të kryeje aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqerise dhe do te veprojne nen mbikqyrjen e Administratorëve të **“MAM DISTRIBUTION” Sh.p.k.**

**NENI 5
Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

5.1. Shoqëria “**MAM DISTRIBUTION**” Sh.p.k ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.2. Veprimtaria e Shoqërisë “**MAM DISTRIBUTION**” Sh.p.k, do të ketë për objekt: “*Tregeti me shumice dhe pakice e artikujve te tjere per femije, aksesore, veshje, import-eksport, etj*”.

5.2.2 Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;

5.2.3 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

5.3 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakësohet në bazë të vendimit të Asamblese së Përgjithshme.

III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA

NENI 6 Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

NENI 7 Kapitali i Shoqërisë

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë “**MAM DISTRIBUTION**” Sh.p.k perfaqesohet nga 1 (nje) kuote me vlere 100.000 (nje qind mije) Lek dhe nuk është paguar.

Pjesemarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë:

- Z. Alvina Zyberaj : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere të përgjithshme 100.000 (nje qind mije) Lek që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 8 Asambleja e Përgjithshme

Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet që ligji apo Statuti ia rezervon ketij organi, si dhe për çështjet për të cilat, Administratori kërkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqërisë “**MAM DISTRIBUTION**” Sh.p.k.

8.2 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- ndryshimit të Statutit;
- riorganizimi i shoqërisë, ndarja, bashkimi, likuidimi, shndërrimi i shoqërisë;
- zmadhimi, zvogëlimi i kapitalit, transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqëria me qëllim anulimin e tyre;

- emërimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emërimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe të gjitha kompetencat e tjera që ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

NENI 9

Organet drejtuese

9.1. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën merr pjesë Ortaku i Vetem i Shoqërisë ose përfaqësuesit e tij të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

NENI 10

Administratori i Shoqërisë

10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, person fizik qe mund te jetë ose jo ortak i Shoqërisë.

10.2 Administratori është i detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin “ Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Statutin, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

10.3 Administratori i Shoqërisë emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje në detyre per një kohë prej 5 (pesë) vjetesh.

10.4 Administator i parë i shoqërisë emerohet:

- Znj.Adela Zyberaj, shtetase shqiptare, lindur më 13.01.1995, në Vlore, Shqiperi, identifikuar me id nr. J55113088F, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

10.5 Administratori ka të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe Statuti i Shoqërisë.

NENI 11

Ligji i zbatueshem dhe mosmarreshjet

11.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, referencë i bëhet legjislacionit shqiptar në fuqi.

11.2. Për të gjitha mosmarreshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, organi kompentent do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11.3. Ky dokument redaktohet ne 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaku themelues

ORTAKU THEMELUES

Z. Alvina Zyberaj

Data 02.04.2024